

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përgjigja - BE thirrje Kosovës e Shqipërisë për përmbajtje: Specialja jep drejtësi të paanshme
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/917654/be-thirrje-kosoves-e-shqiperise-per-permbajtje-specia-lja-jep-drejttesi-te-paanshme/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 16:28:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:43:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1912d04c13495de3898081d9f119d91416ea74b1e7745dbed2582e84ae8b896e
TEKSTI	45e4a29427aafc642ec74b073140b6d33523bd58dde732cebb022b2c26045fdd
PAMJA	bc8e9c60948e55c50942b078117a885bd8a410a49a3b27b2f396c3f696b95eaa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4d2c8e18497c7322ca74681b352b86c85bb56b7240c047d980ec65be92af173b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	01dec896a9f5048ec789d11efc6a4c6ac149c2dbc9d9f31c517f24c69c93634b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4d2c8e18497c7322ca74681b352b86c85bb56b7240c047d980ec65be92af173b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Nga Çim Peka-Tradhtia që s'e panë tu ardhë



BE thirrje Kosovës e Shqipërisë për përmbajtje: Specialja jep drejtësi të paanshme

17:43, 18/09/2026

Bashkimi Evropian i është përgjigjur kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, dhe atij të Shqipërisë, Edi Ramës, në lidhje me reagimet e tyre për dënimin ndaj drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku kreu i qeverisë kosovare e cilësoi vendimin si padrejtësi, ndërsa Rama si 'marre'.

Zëdhënësi i Komisionit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Christian Wigand, tha se Dhomat e Specializuara japin drejtësi duke zhvilluar procedura gjyqësore të drejta, të paanshme dhe të pavarura.

'Shikoni, ajo që mund të them për këtë çështje është se Bashkimi Evropian merr shënim aktgjykimin e shkallës së parë në çështjen e Prokurorisë së Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Dhomat e Specializuara të Kosovës japin drejtësi duke zhvilluar procedura gjyqësore të drejta, të paanshme dhe të pavarura, të bazuara në parimin e përgjegjësisë individuale penale. Personat e dënuar, natyrisht, kanë të drejtë të apelojnë aktgjykimin para gjyqtarëve të pavarur të apelit, në një trup gjykues të veçantë të shkallës së apelit. BE-ja u bën thirrje të gjitha palëve dhe aktorëve në Kosovë dhe në rajon që të tregojnë përmbajtje', tha Wigand, raporton KosovaPress.

Po ashtu, ai u shpreh se mbetet thelbësore të promovohet një mjedis i lirë nga frika dhe hakmarrjet si dhe të mbrohen viktimat dhe dëshmitarët.

Reagime pas verdiktit dënues në Hagë, a do të nisë ndryshimi i Ligjit për Gjykatën Speciale?

Ndërsa, zëdhënësi i Komisionit Evropian për Zgjerim, Guillaume Mercier, iu referua fjalëve të Komisioneres Evropiane për Zgjerim, Marta Kos, duke thënë se aktgjykimet e Dhomave të Specializuara duhen të respektohen dhe se personat e dënuar kanë të drejtë t'i apelojnë ato aktgjykime.

'Dhomat e Specializuara të Kosovës janë një organ gjyqësor i paanshëm dhe i pavarur. Aktgjykimet e tyre duhen të respektohen dhe personat e dënuar kanë të drejtë të apelojnë. Kjo ka të bëjë me përgjegjësinë individuale dhe drejtësinë për viktimat dhe familjet e tyre nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Ne u bëjmë thirrje aktorëve në rajon që të ndihmojnë në shërimin e plagëve të së kaluarës. Vetëm përmes pajtimit vendet e rajonit mund t'i tejkalojnë ndarjet dhe të ecin përpara drejt një të ardhmeje të përbashkët, drejt Bashkimit Evropian', tha ai.

Më 16 shtator, Gjykata Speciale ka marrë vendim të shkallës së parë që Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi të dënohen me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18

më të lexuarat

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Kur Albin Kurti paralajmëronte Kuvendin e Kosovës: VV nuk e njeh Gjykatën Speciale, ne nuk do të dorëzojmë luftëtarët e UÇK

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Granit Xhaka në mbështetje të çlirimtarëve: Luftuan në tokën e tyre për lirinë e atdheut!

dhe Rexhep Selimi me 13 vjet.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Kurti udhëton drejt New Yorkut, takime me liderë botërorë dhe diasporën shqiptare



Avokati i Thaçi reagon me kritika të forta ndaj Gjykatës



Christopher Hill: S'e besoj se Thaçi është përfshirë në vepra të paligjshme

Komentet

Shto koment

Posto

Trupi gjyqës: Krasniqi kishte dijeni për krimet, por nuk ndërmori hapa


Gjykata Speciale: Katër të akuzuarit janë penalisht përgjegjës për krime lufte!

Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës

TË NGJASHME



'Eksod' te Kosova, shkon në katër numri i lojtarëve të tërhequr nga përfaqësuesja



Djali i Jakup Krasniqit: S'dorëzohemi, të bashkohemi të gjithë, shqiptarët e partitë politike



Trajneri Franco Foda publikon listën e Kosovës: Emra të rinj, rikthime dhe mungesa të mëdha



Goditje për Kosovën, mungon një nga mesfushorët kryesorë për ndeshjet e Ligës së Kombeve



FOTO/ Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte



Protesta mbarëkombëtare në Prishtinë, mbledhen qytetarët

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MUZIKË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.